

Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët për vitin akademik 2020/2021 Programi: Menaxhment Industrial

1. Hyrja

Programi Menaxhment Industrial (MI) në kuadër të Fakultetit të Menaxhmenti gjatë vitit akademik 2020/21 ka ofruar mësim për studentet sipas plan-programit të Akredituar në vitin 2019 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Fakulteti Menaxhmenti ka një staf të kualifikuar dhe ka ambiente moderne të punës të cilat u mundësojnë studentëve të fitojnë shkathtësitë e duhura për profesionin, të cilin do ta ushtrojnë në të ardhmen.

Misioni i programit është të krijoj profesionist në fushën e Menaxhmentit Industrial, me fokus në fushën e administrimit të biznesit dhe inxhinierisë, duke ndihmuar në strukturimin dhe organizimin e kompanive industriale për të përmirësuar zhvillimin e kompanisë si dhe gjenerimin e ideve që avancojnë praktikën e menaxhimit; Misioni i programit është në harmoni të plotë me misionin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët për vitin akademik 2020/2021 përmban të dhëna për vlerësimin e programit dhe për vlerësimin e stafit akademik/lëndës, i cili raport krahasohet me dy vitet paraprake.

2. Raporti i përmbledhur i vlerësimit të cilësisë (program dhe stafi akademik/lënda)

Raporti i përgjithshëm - për dy fusha (program dhe stafi akademik/lënda), paraqet në Tabelën nr. 1 – të dhënat për vitin akademik 2020/21 (krahasuar me dy vitet paraprake), i ilustruar edhe në fig.1. Pyetjet për dy fushat kanë qenë të ndërhuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- Pajtohem pjesërisht; 4-Pajtohem; dhe 5- Pajtohem plotësisht).

Tabela.nr.1 - Vlerësimi i cilësisë sipas fushave

	Vitët Paraprake		Viti aktual
	2018/19	2019/20	2020/21
Vlerësimi mësimdhënia/nxënia (programi)	3.80	4.00	3.70
Vlerësimi i stafit akademik / lënda	4.26	4.38	4.12




Fig.1 – Grafika - vlerësimi i cilësisë sipas fushave,

Nga raporti përmbledhur i paraqitur në tabelën nr.1 dhe i pasqyruar në grafikun nr.1 në kuadër të fushës së vlerësimit të programit, gjegjësisht të mësimdhënies dhe mësimnxënies shohim një vlerësim konstant të cilësisë neper tri vitet akademike. Duke i u referuar tabelës, vlerësimi i cilësisë për tri viteve akademike i afrohet notes 4 apo vlerësimi në përqindje nga studentet për programin është rreth 80%, qe konsiderohet një vlerësim shume i mire. Në kuadër të fushës të vlerësimit të stafit akademik/lendes, është një vlerësim konstant neper vite nga studentët, për të tri vitet akademike mesatarja e vlerësimit është me notën 4.21 apo rreth 84% është vlerësimi në përqindje i studenteve për stafin akademik/lëndën - është një vlerësim i shkëlqyeshëm për punën dhe angazhimin e stafit akademik dhe lëndën e ligjëruar.

3. Raporti i vlerësimit të Programit

Raporti vlerësimi për programin MI, paraqet të dhëna për vitin akademik 2020/21 (krahasuar me dy vitet paraprake). Vlerësimi është realizuar përmes pyetësorëve i cili përmban 20 komponente, ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e programit përkatës. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve

dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Bazuar në rezultate e vlerësimit të programi - mësimdhënia dhe mësim-nxënia të paraqitura në tabelën nr.2, vërejmë se të gjitha komponentët e këtij sesi janë vlerësuar pozitivisht nga studentët.

Tabela nr.2 – Vlerësimi i programit – MI

	Vitet paraprake		Viti aktual
	2018/19	2019/20	2020/21
Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave ju ofrohen studentëve rregullisht	4.27	4,25	4.22
Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	4.90	4,17	4.44
Syllabuset e lëndëve ofrohen me kohë studentëve	4.22	3,99	3.60
Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve	4.17	3,89	3.84
Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet	3.55	4,29	3.38
Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse	4.40	4,00	3.34
Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies	3.42	3,28	3.20
Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shume nga ai në klasë	///	4,34	2.40
Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve	///	3,96	3.63
Sallat e mësimi janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për mësim cilësorë	3.98	3,74	3.98
Ekziston një lidhje e mirë e mësimi teorik dhe atij praktik	2.95	4,34	3.30
Studenti është i lirë që vet të përcaktohet për lëndët zgjedhore	4.57	4,22	4.42
Orari i mësimi shpallet me kohë	4.32	4,07	4.28
Orari i shpallur i mësimi respektohet nga mësimdhënësit	3.90	3,99	3.76
Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës	4.05	3,91	3.72
Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera	3.00	3,87	3.46
Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar)	///	3,62	3.51
Vlera e ECTS-së për lëndën është e llogaritur sipas ngarkesës së studentit	3.80	///	///
Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga universiteti	2.80	3,68	3.14
Komunikimi i udhëheqësve të programit me studentët është në shkallën e duhur	3.55	///	///
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	3.30	4,10	3.88
Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitiv	3.00	4,05	///
Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe të tjerëve	3.85	4,25	4.21
Mesatarja e vlerësimit të programit	3.80	4,00	3.70

Nga te dhënat e prezantuar ne Tabelën nr.2 për vlerësimin e programit MI 2020/21 nga studentet ka një vlerësim nen 4 (qe jep indikacione se duhet angazhim për vitet ne vazhdim – me synim te përmirësimit te komponentëve qe kanë pas vlerësim me te ulet – në të cilat ka pas një ndikim edhe pandemia CoVid-19), nga analiza e raportit shihet se disa nga 20 komponentet e vlerësimit janë te vlerësuar me note mesatare mbi 4 qe është një vlerësim i shkëlqyeshëm dhe ka disa komponente qe janë vlerësuar me note mesatare nen 4 qe konsiderojmë se ka hapësirë për te rritur angazhimin me qellim te përmirësimit te vazhdueshëm, komponentët qe kërkojnë një angazhim me te madhe për përmirësim te cilësisë janë: Mësimi “on-line” përmes platformës Microsoft Tims e cila është përdor gjate kohës se pandemisë CoVid-19, Informimi i studenteve me mundësit për punësim pas përfundimit te studimeve, Mënyra e vlerësimit te studenteve, Raporti ne mes pjesës teorike dhe praktike – për këto komponente duhet angazhim i menaxhmentit, komitetit te programit dhe organizim me i mire i stafit për ngritje te cilësisë dhe te rezultateve ne vitet ne vazhdim.

4. Raporti i vlerësimit te stafit akademik/lëndës

Raporti vlerësimi për staf akademik/lëndë, paraqet te dhëna për vitin akademik 2020/21 (krahasuar me dy vitet paraprake). Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së Likert (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Vlerësimi i stafit akademik/lëndës nga studentet është realizuar përmes pyetësorit i cili përmban 13 komponente për te cilat është gjetur nota mesatare. Rezultate e vlerësimit janë paraqitura në tabelën nr.3, nga te dhënat e prezantuara vërejmë se i gjithë stafi akademik/lënda janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare ne nivel te programit për mësimdhënës është 4.12 një vlerësim i shkëlqyeshëm për punën dhe angazhimin e mësimdhënësve ne lëndën përkatëse.

Tabela nr.3 - Vlerësimi i stafit akademik / lëndës

Emri i Lëndëve	Vitet paraprake		Viti aktual
	2018/19	2019/20	2020/21
Gjuhe Angleze I	///	4.08	4.13
Menaxhmenti	///	3.98	4.28
Statistike	///	4.10	4.22
Njohja e materialeve inxhinierike	///	4.11	4.21
Marketing ndërkombëtar	3.80	3.90	3.64
Sjellja Organizative	4.79	4.35	3.31
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4.80	4.47	3.57

Mekanika teknike	///	3.87	3.98
Menaxhimi i Financave	4.57	4.94	4.49
Menaxhimi i operacioneve	4.14	4.88	///
Mbrojtja dhe siguria ne Pune	4.59	4.31	///
Menaxhimi i dijes dhe inovacioni	3.68	4.68	4.12
Biznesi ndërkombëtar	4.48	4.61	///
Informatika ne biznes	///	4.99	4.36
Matematika ne biznes	///	4.16	4.25
Grafika inxhinierike	///	4.38	4.35
Hyrje ne ekonomi	///	4.71	4.37
Shkathësi akademike	///	4.36	4.20
Teknika e matjes	4.86	///	4.54
Termodinamika	4.86	///	///
Gjuhe Angleze II	4.64	///	4.52
Menaxhimi i Cilesise	4.11	///	///
Kontabiliteti	4.82	///	4.39
Projektimi i linjave te prodhimit	3.55	///	///
Projektimi i proceseve teknologjike	3.75	///	3.60
Teknologjia e prodhimit	3.39	///	///
Teknologjia e proceseve teknologjike	3.16	///	///
Baza e te dhenave	4.64	///	///
Etika ne Biznes	4.55	///	4.18
Menaxhimi i transportit dhe shpedicionit	4.40	///	///
Menaxhimi i projekteve inxhinierike	3.65	///	3.23
E-biznesi	4.49	///	3.60
NVM	4.21	///	3.60
Mesatarja e vlerësimit	4.26	4.38	4.12

Nga te dhënat e prezantuar ne tabelën nr.3 – vërejmë se për stafin akademik dhe lëndët te cila janë pjesë te programit Menaxhmenti Industrial 2020/21, janë vlerësuar me note mesatare mbi 4, qe është një e arritur e jashtëzakonshme për këtë program. Duke analizuar detajet e raportit vijmë ne **përfundimin** se ka disa mësimdhënës dhe lëndë te cilat kane marre një vlerësim me te larte (mbi notën 4) dhe ka disa mësimdhënës dhe lëndë qe kane marrë një vlerësim me te ulët (nen notën 4), ne baze te këtyre te gjeturave **rekomandojmë** qe menaxhmenti i programit se bashku me mësimdhënësit dhe komitetin e programit duhet te angazhohen për te rritur nivelin e përgjegjësisë profesionale nga mësimdhënësit ne te gjitha lëndët te cilat kane një vlerësim me notën nen 4, duke bere përpjekje qe këto vlerësime te përmirësohen ne vitet pasuese dhe njëkohësisht duhet te mbaje nivelin e mësimit te ato lëndë qe janë vlerësuar me note mbi 4 duke pasur tendence te përmirësimit te vazhdueshëm.